



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0398

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Agon Ramadani - Kryetar duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Zeroline" SH.P.K., "Florije Jahaj", "Geocad Group" SH.P.K., "Infra-Plus" SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, inicuar nga Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Konkurs projektimi për hartimin e projektit kryesor të nënkalimit në pikëtakimin e rrugës magjistrale M2 me rrugën A-lagjen Kalabria" me numër të prokurimit 616-22-14679-4-1-3, me 10/10/2023, mori:

Vendim

- Aprovohen si pjesërisht**, të bazuara ankesat e OE "Zero line" SH.P.K. e dates 15. 06. 2023 me numër 398/23, ankesa e OE "Florije Jahaj" e dates 16. 06. 2023 me numër protokolli 399/23, ankesa e OE "Geocad Group" SH.P.K e dates 16. 06. 2023 me numër protokolli 403/23, si dhe ankesa e OE "Infra-Plus" SH.P.K e dates 16. 06. 2023, me numër 409/23, kurse vendimi i AK- Komuna e Prishtinës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Konkurs projektimi për hartimin e projektit kryesor të nënkalimit në pikëtakimin e rrugës magjistrale M2 me rrugën A-lagjen Kalabria" me numër të prokurimit 616-22-14679-4-1-3 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit **anulohet në tërësi**.
- Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
- Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e operatoreve ekonomik ankues.

Arsyetim

Faktet dhe rrethanat procedurale

Autoriteti kontraktues- Komuna e Prishtinës me datën 04.01.2023 ka publikuar njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Konkurs projektimi për hartimin e projektit kryesor të nënkalimit në pikëtakimin e rrugës magjistrale M2 me rrugën A-lagjen Kalabria" me numër prokurimi 616-22-14679-4-1-3. Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e

publikuara është publikuar me datën 31.01.2023.

AK me datën 29. 05. 2023 ka publikuar njoftimin për rezultatet e projektimit.

Me datën: 02.06.2023, OE “Florije Jahaj” në autoritet kontraktues ka dërguar kërkesën për rishqyrtim, lidhur me aktivitetin e lartpërmendur. Poashtu kërkesë për rishqyrtim kanë dërguar edhe OE Infra Plus” me datën 01. 06. 2023 si dhe OE “Zeroline” me datën 01. 06. 2023.

Si palë e pakënaqur me vendimin e AK-së, operatori ekonomik 15.06.2023, OE “Zeroline SH.P.K.”- Prishtinë, përmes sistemit të e-prokurimit, ka parashtruar ankesë në OSHP me numër 398/23 (numër protokolli). Poashtu me datën 15. 06. 2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 399/23 OE “Florije Jahaj”- Prishtinë.

Për aktivitetin e prokurimit të cekur si më lartë me datën 16. 06. 2023 ka parashtruar ankesë OE “Geocad Group SH.P.K.”- Prishtinë, me nr: 2023/0403 si dhe OE “Infra-Plus” SH.P.K-Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0409.

Shqyrtimi paraprak i ankesës

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë në OSHP vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe e njëjta bije nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 11. 07. 2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesat e OE-ve ankues të aprovohen si te bazuara,
- të anulohet vendimi i AK-së dhe lënda të kthehet në rivlerësim

Administrimi dhe vlerësimi i provave

Duke ju referuar veprimeve të ndërmarra si më sipër, Paneli Shqyrtues konsideron se janë plotësuar kushtet për të vendosur në mënyrë meritore mbi këtë çështje, sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, duke pasur parasysh faktin se aktet dhe veprimet dhe parashtruesat e palëve, provat në dispozicion dhe raporti i ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me çështjen.

Konstatimet e Panelit Shqyrtues

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtruesat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha

ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se aktiviteti i referuar përmban shkelje të dispozitave ligjore, të precizuara dhe të argumentuara ato në ankesat e OE-ve dhe në raportin e ekspertit shqyrtues. Paneli shqyrtues sqaron se raporti i ekspertit shqyrtues nuk prodhon efekte detyruese për asnjërën nga palët dhe as për panelin shqyrtues, prandaj i njëjti (natyrisht dhe vlerat provuese të tij) gjithnjë analizohen në raport me të gjitha shkresat e një lënde, me rrjedhën e procesit të prokurimit, veprimet e palëve, qëllimin dhe natyrën e një aktivitetit të prokurimit, i cili në parim synon përmbushjen e nevojave publike, me përdorimin e fondeve publike, të cilat i janë besuar secilit AK, në cilin do nivel.

Paneli shqyrtues vlerëson se procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve nuk është bërë konform neni 59 të LPP-së, dhe gjithashtu nuk është respektuar neni 72 dhe 7 i LPP-së, përveç tjerash paneli vlerëson se ky aktivitet ka humbur qëllimin siç specifikon neni 1 i LPP-së prandaj pretendimet ankimore dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues, nga ana e Panelit, gjejnë mbështetje në mënyrë të pjesshme andaj si zgjidhje e duhur u konsiderua anulimi i tërësishëm i aktivitetit për arsyet që do të shtjellohen si më poshtë.

Arsyet kryesore që orientuan drejt vendim-marrjes sikurse në dispozitiv të këtij vendimi janë:

1. Kriteret e paqarta si dhe në kundërshtim me legjislacionin në fuqi në DT relevante
2. Zbulimi i identitetit të 4 (katër) OE-ve pjesëmarrës në këtë aktivitet
3. Papërgjeshmëria e OE të rekomanduar sipas ekspertit në relacion me pretendimet ankimore të OE-ve ankues

Lidhur me katër ankesat e paraqitura si objekt shqyrtimi, nga ana e panelit është konsideruar se të njëjtat në parim përmbajnë pretendime të ngjashme, që konsistojnë në eliminim e tyre si dhe në pretendimet ndaj të OE të rekomanduar për kontratë, andaj të njëjtat do të trajtohen bashkërisht për faktin se pas analizimit dhe shqyrtimit të të njëjtave konform raportit të ekspertit i cili shumicën relevante të pretendimeve në ankesa i ka klasifikuar si të bazuara, ndërsa rekomandimi për rivlerësim nuk ka gjetur mbështetje nga ana e panelit për faktin se është konsideruar si i pamundshëm duke pasur parasysh arsyet e mësipërme si dhe vetë përgjigjet e ekspertit në raportin e tij.

Nga ana e panelit çështja kyçe që ka orientuar drejt anulimit të kësaj procedure ka qenë çështja e ngritur në ankesat e OE-ve ankues lidhur me pretendimin e kriterëve të pa-qarta si dhe që të njëjtat bien ndesh me legjislacionin në fuqi, me ç'rast është pretenduar se:

Tek projekti ideor, pjesa grafike, është kërkuar :

- Shënimet mbi veprimtarinë e Kompanisë Projektuese dhe dokumentacioni profesional i pjesëmarrësve tjerë në këtë konkurs.
- Dokumentacionin mbi Regjistrimin e Kompanisë dhe dokumentacioni identifikues pjesëmarrësve tjerë në këtë konkurs.

Duke marrë parasysh kërkesat e mësipërme e poashtu raportin e ekspertizës i cili në përmbajte të tij ka potencuar se ky pretendim klasifikohet si i bazuar, PSH konstaton se kjo kërkesë bie ndesh me legjislacionin në fuqi si dhe në bazë të kësaj kërkesë, ka mundur të arrihet deri tek zbulimi i

identitetit i të gjithë ofertuesve dhe jo vetëm ankuesve, andaj kjo bie ndesh me nenet 55.13 deri ne 55.17 te RRUOPP-së. Si dhe nenit 27 të LPP-së kështu që rrjedhimisht ka mundur të arrihet deri tek zbulimi i të gjithë pjesëmarrësve në këtë aktivitet, andaj edhe u konsiderua se rivlerësimi në këtë situatë është i pamundshëm dhe i kotë, andaj në rast të ri tenderimit AK të sigurohet se përpilimi i DT është në harmoni me legjislacionin e referuar e poashtu të vërtetohen edhe nën kriteret e vendosura të cilat janë pretenduar se nuk janë aktuale dhe bazohen në projekte/plane të mëhershme, që mund të ndryshojnë gjendjen faktike në relacion me nevojat e AK-së, kështu që lidhur me këtë çështje PSH mbështet mendimin e ekspertit i cili konstaton se ky pretendim është i bazuar, ndërsa nuk e mbështet rekomandimin përfundimtar.

Vlen të theksohet se në këtë aktivitet të prokurimit nga gjithsejtë 7 oferta të paraqitura, përgjatë procedurave të këtij aktiviteti 4 OE pjesëmarrës janë eliminuar si shkak i zbulimit të identitetit të tyre, ndërsa pas vlerësimit vetëm një nga OE-të pjesëmarrës ka kaluar pragun prej 70 pikëve që ka qenë si kriter që të vazhdohet në fazën e dytë.

Si objekt shqyrtimi i pretendimeve në të ankesat e OE-ve ankues fillimisht ka qenë çështja e zbulimit të identitetit të OE-ve pjesëmarrës në këtë aktivitet prokurimi, të cilët kanë pretenduar se kjo është kërkuar nga zyrtarja e pranimit të ofertave, ndërsa AK ka mohuar se kjo është kërkuar nga ana e tyre dhe kanë eliminuar pjesëmarrësit të cilët ishin identifikuar, me ç'rast poashtu është kërkuar opinion nga KRPP, bazuar në raportin e ekspertit shqyrtues mund të veçohet se në përmbajtje të ankesave dhe pretendimeve të paraqitura kanë qenë si në vijim (marrë nga raporti i ekspertizës):

AK-ja – Zyrtari përgjegjës i prokurimit me datën 06.03.2023 me kërkesë për interpretim i drejtohet KRPP-së, me kërkesë se: Në regjistrin e dorëzuar te OE, tre Aplikues kanë shënuar numrin e biznesit, ndërsa projektet janë me shifra. Andaj sektori i Prokurimit – Komuna e Prishtinës, kërkon nga KRPP interpretim ligjor, se a duhet të pranohet oferta e dorëzuar, apo te refuzohet. Eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja nuk e ka bërë kërkesën për interpretim për çështjen në fjale sepse nuk e ka spjeguar të gjithë procedurën se si ka arritur deri te shënimi i numrit të biznesit dhe jo vetëm numri katër shifror i kërkuar për këtë aktivitet të prokurimit.

KRPP me datën 13.03.2023 i përgjigjet AK-se në kërkesen për Interpretim duke e interpretuar: Dosjen e konkursit të projektimit. Dërgesa e dosjes se konkursit për projektim në Nenet 55.13, 55.14, dhe 55.15 të Rregullores për Prokurim Publikë

“Sa i përket çështjes për të cilën na keni shkruar, “Në një aktivitet të prokurimit - Konkurs të projektimit, në regjistrin e dorëzuar OE-të kanë shënuar numrin e biznesit, ndërsa, projektet janë me shifra, andaj, a duhet të pranohen ofertat e dorëzuar, apo te refuzohen, KRPP sqaron si në vijim:

Pjesëmarrësit në konkursin e projektimit do ti dorëzojnë propozimet e tyre në përputhje me nenet 55.13, 55.14 dhe 55.15 të Rregullores për Prokurim Publikë, duhet të vendosen në DT kërkesat për dorëzim të propozimeve dhe OE-të duhet ti dorëzojnë propozimet ashtu si është përcaktuar në Dosjen e Konkursit të Projektimit dhe në Njofimin për konkurs Projektimi”.

Mirëpo KRPP nuk interpreton problemin e paraqitur me rastin e dorëzimit të tenderëve pasi që AK-ja nuk e kërkon interpretimin ashtu si ka ndodhur, e i cili ka ndodhur me insistimin e zyrtarit pranues i cili është staf i AK-së dhe i cili zyrtar është dashtë të jetë mirë i informuar për

procedurën e pranimit/ regjistrimit të tenderëve të dorëzuar në procesverbal.

Andaj lidhur me këtë çështje, Paneli vlerëson se konform legjislacionit në fuqi nuk lejohet që të vazhdohet me procedura të mëtutjeshme nëse zbulohet identiteti i pjesëmarrësve, veprim që mund të evidentohet në të dhënat e paraqitura, ndërsa sa i përket arsyeve se pse të dhënat janë vendosur si dhe si është arritur në këtë situatë, paneli konsideron se kjo çështje është jashtë kompetencave, juridiksionit kapaciteteve dhe fushe-veprimtarisë së OSHP dhe se në rast dyshimi të elementeve të veprave penale, palët mund ti drejtohen organeve kompetente, ndërsa paneli konstaton se veprimet e ndërmarra, pavarësisht se nga kush janë shkaktuar, si rrjedhojë kanë ndikuar në ngushtimin e konkurrencës në masë të madhe në këtë aktivitet të prokurimit, diskriminimin eventual të OE-ve pjesëmarrës, që si pasojë përfundimisht ka humbur qëllimin e vazhdimit të këtij aktiviteti (referuar nënve 1, 6, 7, të LPP-së) andaj kjo çështje është konsideruar si njëra ndër arsyet e anulimit të procedurës.

Përveç tjerash, PSH konstaton se rrethana plotësuese për të arritur deri tek vendim-marrja në dispozitiv ka qenë çështja e OE të rekomanduar për kontratë, lidhur me të cilin OE-të ankues kanë paraqitur pretendime mbi plotësimin e kërkesave, me ç'rast eksperti shqyrtues shumicën relevante të pretendimeve ndaj OE të rekomanduar i ka cilësuar si të bazuara, andaj rrjedhimisht edhe po të konsiderohej që OE i rekomanduar nuk ka plotësuar kërkesat e parashtruara në aspektin teknik (konform ekspertizës), bazuar në çka u tha si më sipër mund të arrihet në përfundimin se duke qenë se OE i rekomanduar sipas ekspertit nuk plotëson kërkesat, dy operatorët tjerë bazuar në raportin e vlerësimit nuk kanë kaluar fazën e parë si dhe operatorët tjerë janë eliminuar, edhe kjo situatë do të arrinte në mungesë të ofertave të përgjegjshme për rekomandim të kontratës.

Andaj përfundimisht duke u bazuar nga të gjitha që u thanë si më sipër PSH konstaton zgjidhja e duhur dhe e vetme lidhur me këtë aktivitet prokurimi ka qenë anulimi i tërësishëm i tij, ndërsa sa i përket pikës 3 të dispozitivit është arritur deri në këtë mënyrë vendim-marrje për faktin se anulimi i procedurës nga ana e panelit konsiderohet se i atribuohet në masë më të madhe AK-së se OE-ve pjesëmarrës, andaj deri te anulimi është konsideruar se është arritur jo me shkaktimin e OE-ve pjesëmarrës, por duke u bazuar në rrethanat e mësipërme.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Agon Ramadani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimin të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - ZEROLINE SH.P.K., Florije Jahaj, GEOCAD Group SH.P.K., " Infra-Plus " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: